

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 1058 REP
NR 612 KOL



AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

"ERDAT" sh.p.k TIRANE

Sot me date 10 Prill 2004, para meje MIMOZA SADUSHAJ, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha", Pall. 13, ap. 2, u paraqit personalisht :

z. PRENG DOCI, i biri i Lleshit, lindur me 05.12.1949 ne Diber dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte 1442532.

i cili me kerkoi perpilimin dhe redaktimin e ketij Akti Themelimi, per krijimin e shoqerise " ERDAT" shpk, Tirane, ne baze te Ligjit 7667, date 28 Janar 1993, " Per Shoqerite tregtare ", aktiviteti i se ciles rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare dhe prodhuese me pergjegjesi te kufizuar, emir i se ciles eshte " ERDAT" Shpk, Tirane .

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr " Jordan Misja" nr 3.
Shoqeria mund te hape dege e filiale si ne Shqiperi dhe jashte saj .
Aktiviteti i tyre rregullohet nga legjislacioni i vendit ku ato operojne.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :

-Ndertime te ndryshme civile dhe ekonomike, germime dheu me punime eventuale murature, punime dhe prishje ne toke te germuar, prodhim materiale inerte-gure, prodhime elemente te betoni e betonarmeje te zakonshme, pararendur-gure dekorative, ndertim rruge kat III dhe II-I, punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,ndertim mbi shtresa rrugore, ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m, ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m Estakada-ura metalike te varura, ndertime tunele rrugore-hekurudhore, ndertim ujesjelles kanalizime kanale e implante vaditjeje, punime mbrojtje te sistemit hidraulik-cimentime etj, ndertime dige-damba deri ne 10 m, ndertim galeri tunele, sillose kullauji, etj b/a metalike, punime karpentiere, eksport-import artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, elektroshtepiake, hidrosanitare,prodhime bujqesore, blegtorale, pije freskuese, pije alkoolike, Bar- Kafe- Restorant.

tregtimi me shumice dhe pakice , I pajisje elektronike, kompjuter, sisteme hidrosanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanale, prej alumini, materiale druri, te perpunuara dhe grezzo, mobilie, materiale qe kane lidhje me lenden e pare te te gjitha tipeve, materiale ndertimi, materiale plastike, kimike dhe nenproduktet e tyre, linja te makinerive te fushes se prodhimit, perpunimi I bimeve mjeksore dhe eterovajore,

Neni 4

Kapitali themeltar eshte 100,000 leke (njeqindmije), i paguar teresisht nga ortaku i shoqerise PRENG DOCI:

Neni 5

Administrator i shoqerise do te jete **Z. PRENG DOCI**.

Neni 6

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat prej 10 vjetesh, ky afat mund te modifikohet ose te zgjatet ne rastet qe parashikon statute I shoqerise.

Neni 7

Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj vetem pas rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se I-re Tirane.

Neni 8

Shoqeria do te paiset me dokumentin perkates me regjistrimin prane organit tatimor.

Neni 9





Fitimi qe do te rezultoje, pas heqjes se shpenzimeve te aktivitetit te njohura me ligj dhe pas zbritjes se shumave te tatimit, do te disponohet nga ortakut I shoqerise.

Neni 10

Organi vendimmarres I shoqerise eshte asamblea e ortakeve qe perfaqson shoqerine juridikisht par ate gjitha organeve dhe organizmave te shtetit si dhe ne marredhenie me te tretet, kur veprimet kane te bejne me interesa materiale te shoqerise.

Neni 11

Drejtues teknik I shoqerise eshte Z DOD DOCI, me licence Z 2233/2.

Aktivitet e shoqerise do te konsiderohen ato aktivitete juridike dhe civile qe kryhen nga organet e shoqerise apo nga ato te ngarkuara nga ajo ne perputhje me statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 12

Normalisht veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, pervecse kur nje gje e tille kerkohet nga organet ligjore kompetente.

Neni 13


Shoqeria shperbehet ne baze te statudit te shoqerise.

Neni 14

Dispozita me te detajuara ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e shoqerise jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise, bashkengjitur.

ORTAKU THEMELUES

PRENG DOCI



HOTERE



The stamp is circular and contains the text "TIRANE" at the top, "K. P. N. S. H. S. H." in the center, and "SHOQERIA" at the bottom. It also features a central emblem.

S T A T U T

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" ERDAT" Shpk, TIRANE



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " ERDAT, shpk, Tirane, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 7632, date 04.11.1992 te Kodit Tregetar, Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, per Shoqerite Tregetare dhe akteve te tjera ligjore.

NENI 2

Ortaku themelues I saj eshte :

PRENG DOCI

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

NENI 3

Ortaku themelues i shoqerise ne kete siper marrje ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

NENI 4

Shoqeria " ERDAT,, shpk, Tirane, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se I-re Tirane dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent. Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "ERDAT,, shpk, Tirane.

EMRI, QENDRA, TERRITORI

NENI 5

Emri i Shoqërisë është "ERDAT shpk, Tirane.

Neni 6

Selja e Shoqërisë është në Tirane, Rr "Jordan Misja" Nr 3.

AFATI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Aktiviteti tregëtar i Shoqërisë do të zhvillohet me një afat mbi 10 vjet, ky afat fillon me datën e regjistrimit në Regjistrin Tregëtar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

OBJEKTI

NENI 8

-Ndertime të ndryshme civile dhe ekonomike, germime dheu me punime eventuale murature, punime dhe prishje në tokë të germuar, prodhim materiale inerte-gurë, prodhim elemente të betoni e betonarmeje të zakonshme, pararendur-gurë dekorative, ndërtim rrugë kat III dhe II-I, punime të mirembajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore, ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m, ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m Estakada-ura metalike të varura, ndërtime tunele rrugore-hekurudhore, ndërtim ujësjelles kanalizime kanale e impiante vaditjeje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik-cimentime etj, ndërtime dige-damba deri në 10 m, ndërtim galeri tunele, sillose kullauji, etj b/a metalike, punime karpentiere, eksport-import artikujve të ndryshëm industriale, ushqimore, elektroshtepiake, hidrosanitare, prodhimë bujqësore, blegtorale, pije freskuese, pije alkoolike, Bar- Kafe- Restorant.

tregtimi me shumicë dhe pakicë , I pajisje elektronike, kompjuter, sisteme hidrosanitare dhe hidraulike, prodhimë qeramike, artizanale, prej alumini, materiale druri, të përpunuara dhe grezzo, mobilie, materiale që kanë lidhje me lenden e parë të të gjitha tipeve, materiale ndërtimi, materiale plastike, kimike dhe nenproduktet e tyre, linja të makinerive të fushës së prodhimit, përpunimi i bimeve mjeksore dhe eterovajore,

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 9

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke (njëqindmijë leke), i derdhur teresisht nga ortakët e shoqërisë :

PRENG DOÇI dhe konkretisht 100.000 LEKE OSE 100% TE KAPITALIT:



Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Shoqeria fiton pronesine e plote te shumave, te sendeve dhe te drejtave qe i japen si kontribut nga ortakët apo qe ajo i fiton nepermjet burimeve te saj.

NENI 10

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te tranferueshme si nepermjet ortakëve ashtu edhe ne favor te te treteve.

Ortaku qe ka ndermend te cedoje, qofte edhe pjeserisht e tij te kapitalit, fillimisht duhet ti komunikojë shoqerise projektin e transferimit. I takon shoqerise, nepermjet Administratoreve te saj, qe te ftojë ortakët e tjere per te ushtruar te drejten e parablerjes proporcionalisht me pjesët e kapitalit qe ata zoterojne. Nese shoqeria nuk jep pergjigje brenda nje muaji nga dita e marrjes se projektit te transferimit, atehere ky quhet e miratuar. Nese ortakët deshirojne te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes, ata duhet te ushtrojne ate brenda nje muaji nga data e refuzimit te projektit te transferimit. Ne rast te kundert ata duhet te lejojne transferimin e pjeseve te kapitalit tek te tretet. E drejta e parablerjes nuk mund te ushtrohet pjeserisht mbi pjesët e ofruara qe i takon te bleje cdo ortak. Kushtet e ofruara te treteve nuk mund te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakëve.

NENI 11

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri me akt noterial.

NENI 12

Drejtues teknik I shoqerise eshte Z Dod Doci me nr licence Z2233/2

Ortaku gezon gjithashtu te drejten qe te terhiqet nga aktiviteti i shoqerise dhe per kete duhet te njoftojne shoqerine te pakten 30 dite perpara. I takon shoqerise te procedoje me likuidimin e kuotes se ortakut qe terhiqet, vleresuar ne baze te gjendjes pasurore qe figuron ne bilancin e aprovuar nga shoqeria.

Megjithate e drejta e heqjes dore nuk mund te ushtrohet perpara se ortak i te kete kontribuar ne shoqeri.

ORGANET DREJTUESE

NENI 13

Organet e shoqerise jane:

-Asambleja e ortakëve

-Administrator i shoqerise eshte z.PRENG DOCI.

NENI 14



Asambleja e ortakeve perben organin vendimor te shoqerise dhe perfaqson teresine e ortakeve.

Ajo mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

Asambleja e zakonshme thiret te pakten 1 here ne vit pas mbylljes se vitit financiar. Ajo thiret nga Administratori i shoqerise , nepermjet nje letre rekomande apo telegrami derguar ortakeve te pakten 8 dite perpara mbledhjes se ortakeve. Njoftimi duhet te permbaje ditën , vendin e mbledhjes si dhe rendin e dites.

Asambleja quhet rregullisht e mbledhur edhe ne mungese te modaliteteve te mesiperme sa here qe eshte prezent apo i perfaqsuar i tere kapitali i shoqerise dhe eshte prezent organi administrativ. Megjithate ne cdo rast ortaket duhet te pranojne rendin e dites.

Asambleja e zakonshme vendos me shume se gjysmen e pjeses se kapitalit.

Neni 15

Asambleja e jashtezakonshme thirret sa here qe organi administrativ e quan te nevojshme per ekzigjencat e shoqerise.

Asambleja e jashtezakonshme vendos me $\frac{3}{4}$ e kapitalit te shoqerise.

I takon asamblese se jashtezakonshme te vendose per:


- rregullimin e veprimeve ekonomike te shoqerise qe mbyllen me 31.12. te cdo viti
- emeron administratorin e shoqerise
- ndryshime ne Statutin e shoqerise;
- uljen apo rritjen e kapitalit te shoqerise.
- prishjen perpara kohe apo zgjatjen e aktivitetit te shoqerise.
- krijimin e rezervave jo te detyrueshme nga fitimi i realizuar.
- krijimi i hipotekave, kontraktimi i kredive e huave nga dhe ne favor te te treteve.

NENI 16

Asambleja e ortakeve kryesohet nga administratori i shoqerise . I takon ketij te fundit te verifikojne rregullshmerine e pjesmarrjes se ortakeve. Cdo ortak mund te perfaqsohet ne asamble nga nje ortak tjetër apo nga nje i trete nepermjet, nje akti delegimi, nenshkruar sipas firmes se depozituar ne librin e ortakeve. Mund te marrin pjese ne Asamble vetem ata ortake qe rezultojne te regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga ortaket e shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe nuk i jane lene ne kompetence.

NENI 17



Vendimet e asamblese te marre konform ligjit e ketij statuti jane te detyrueshme per ortaket, qofshin keta ne mungese apo kunder.

NENI 18

Organi administrativ i shoqerise eshte Administratori i shoqerise.
Administratori i shoqerise eshte percaktuar qe ne aktin e themelimit te shoqerise.
Dhe eshte Z PRENG DOCI .

NENI 19

Ai delegohet nga asamblea e ortakeve per zhvillimin e te gjitha funksioneve te metejsme administrative, financiare, juridike, me te drejta te plota per te firmosur ne emer te shoqerise.

Administratori qendron ne detyre per tre vjet nga dita e themelimit te shoqerise dhe mund te rizgjidhet nga Asamblea e ortakeve ne momentin e skadimit te mandatit .

NENI 20

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i emeruar nga Vendimi i Ortakeve, keta te fundit miratojne aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme .

NENI 21

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga asamblea e ortakeve me shumice votash per motive qe i parashkon ligji shqiptar..

MAREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE


Neni 22

Shoqeria " ERDAT" shpk, Tirane, mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore drejteperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas e te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport-importet.

NENI 24

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga Administratori i saj, ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

NENI 25



Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

NENI 26

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore, etj. Sipas ligjit te tatimit mbi fitimin, percaktohen tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave te vendit e te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

NENI 27

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj.

NENI 28

Te ardhurat nga veprimtaria private, do te sigurohen sipas cmimeve qe i cakton vete shoqeria. Cmimet dhe tarifat dhe te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

NENI 29

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte, shoqeria paguan nje tatim ne perqindje te shumes se fitimit qe transferohet.

NENI 30

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar, administratori ose persona te tjere te caktuar prej saj, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 31

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne fund te vitit kalendarik. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

MAREDHENIET E PUNESIMIT

NENI 32



Ortaket e Shoqerise vendosin per shtimin ose paksimin e numrit te ortakeve si dhe per personat e tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e Shoqerise.

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas dispozitave ligjore te legjislacionit shqiptar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 33

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te Shoqerise.

NENI 34

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "ERDA " shpk, Tirane, caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga Ortaku i shoqerise.

NENI 35

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit fillestar ne kapitalin baze.

NENI 36

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi I vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

NENI 37

Kur pushon aktiviteti I shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, i takon Ortakut te shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 38

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve nga dita e konstatimit, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.



NENI 39

Gjykata mund ti ofroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund ta prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne ditën ne te cilen ajo mblidhet per te marre vendim.

NENI 40

Ne rast se shoqeria nuk priset, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlerë jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 41

Mosmarreveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Shkalles se I-re Tirane.

NENI 42

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, I referohet ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ne Republikën e Shqiperise" si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit Shqiptar.

U nenshkrua ne Tirane, sot me date .2004

ORTAKU THEMELUES

PRENG DOCI

